

## KUMTESA DHE SHENIME

### KHEVAT LLOSHI

#### RRETH DISA ÇFAQJEVE TË NDIKIMIT TË HOMONIMISË NË GJUHËN SHQIPE

Homonimia, tingëllimi i njëjtë i njësive të ndryshme leksikore, ze një vend të veçantë në rrethin e fenomeneve të gjuhës. Arësyeja kryesore e lindjes së saj është se gjuha ndryshon, lëviz, zhvillohet në të gjitha pjesët e sistemit të vet. Fjalë dikur krejt të largëta, me ndryshimin e gjatë fonetik që pësojnë në përputhje me ligjet e brendëshme të gjuhës shqipe, dalin më në fund me tingëllim të njëjtë. Nga vëzhgimet mbi homonimet në gjuhën shqipe del se ato kanë lindur edhe gjatë fjalëformimit, ndërsa një numër i madh dalin gjatë huazimit të fjalëve të ndryshme dhe gjatë hyrjes në gjuhën letrare të shkruar e të folur të fjalëve nga dialektet, e së fundi, në raste të veçanta, homonimia lind për shkak të largimit të madh të kuptimeve të po asaj fjale, për shkak të zbërthimit të polisemisë.<sup>1</sup>

Të gjitha këto rrugë jo rrallë shpien në lindjen e pashmangëshme të homonimisë ndërmjet fjalëve të ndryshme të shqipes dhe atëhere ajo bëhet një fakt objektiv në gjuhë. Si e tillë ajo hyn në marrëdhënie me faktet e tjerë të gjuhës dhe mund të lerë gjurmët e veta në zhvillimin e tyre, duke i dhënë atij një drejtim tjetër, që nuk pritej. Në të gjitha këto raste flasim për *ndikimin e homonimisë në gjuhë*. Në lëmin e leksikut ky ndikim, nga natyra e vet, mund të jetë në dy drejtime kryesore të kundërta:

I. Dy ose më shumë fjalë, që përfundojnë si homonime, ka raste që sjellin vështirësi gjatë përdorimit në gjuhën shqipe; duke patur plotësisht të njëjtën trajtë fonetike, ndërsa shënojnë sende e nocione krejt të ndryshme, ato prishin kthjelltësinë e mendimeve. Atëhere veshjet e njëjta fonetike ndeshen dhe ose njera, ose të dyja bashkë i nënështrohen ndryshimeve të mëtejshme, për të zhdukur ose fshirë homoniminë e padëshirueshme. Në këto raste flasim për reagim, *kundërveprim të gjuhës ndaj homonimisë*.

II. E kundërta ngjet, kur fjalët që dalin homonime, i shtyjnë folësit të vendosin ndërmjet tyre edhe një farë lidhje të kuptimeve. Veshja e njëjtë fonetike disa herë lind idenë edhe për një afëri të përmbajtjes. Atëhere kuptimet e fjalëve ushtrojnë një ndikim mbi njeri tjetrin dhe mund të arrihet deri në shkrirjen e plotë të fjalëve, dikur të ndryshme. Një fenomen i tillë është *kontaminimi homonimik*, shkrirja në një fjalë të vetme.

Shqyrtimi i çfaqjeve që vihen re në të dy drejtimet do të na ndihmonte për të hedhur dritë edhe mbi ndonjë nga veçoritë specifike të homonimisë.

1) Më hollësisht shih *Vëzhgime mbi homonimet në gjuhën shqipe*, në «Studime Filologjike», 1964, Nr. 2, f. 45-64.

I. Kundërveprimi i shqipes ndaj homonimisë vihet re në disa fusha dhe gjuha ka për këtë mjete e rrugë të ndryshme, të cilat mund të shpjen: 1. në zhdukjen e plotë të njerës ose të dy fjalëve; 2. në ndryshime të pjesëshme.

1. Zhdukja e fjalëve është ndikimi më i fuqishëm e më karakteristik, që mund të ushtrojë homonimia në gjuhë dhe që shpie në ndryshimet më rrënjësore.

Emri *gjedh-i* për bagëti e trashë mendohet<sup>2</sup> se mund të jetë zhdukur në toskërishten, sepse atje shqiptohet *gjeth*, e dilte homonim me *gjeth-i* për gjethe. Të dyja fjalët, si duket për shkak të kuptimeve që i bëjnë të përdoren në po ata kontekste dhe pranë e pranë, e ngatërrojnë qartësinë e të folurit e prandaj e para ra fare. Në krahinën e Korçës nuk dëgjohet fjala *dreq*, në vend të saj kemi *djall*, mendojmë se kjo mund të shpjegohet me homoniminë e saj me ndajfoljen *dreq*, që përdoret atje gjerësisht për *drejt*. Emri *dreq* në togjet e zakonshëm me foljet ku përdoret shumë shpesh ndajfolja, si p.sh. ecë *dreq*, rri *dreq*, folë *dreq* e mjaft të tjera, do të shkaktonte keqkuptime të padëshirueshme e të përherëshme. Po ashtu, për shkak të shqiptimit të tingullit *rr* pothuaj njësoj me *r*, fjala *arrë* tingëllon e njëjtë me *arë* për fushën e punuar. Të dyja fjalët përdoren shpesh dhe në kontekste që përkojnë; fjali si: *kam një arrë afër shtëpisë* do të dilnin të paqarta e prandaj kjo do të jetë arësyeja e rënies së *arrë* e zëvendësimit të saj me *kaçkë*. Në të folmet, ku përdoret fjala *çikë* në kuptimin grimcë, copëz nuk ndeshet kuptimi *çikë* për vajzë, dhe anasjelltas, atje ku *çikë* përdoret për vajzë, nuk ndeshen kuptimet e tjera. Ky përjashtim i dyanëshëm, na duket neve, mund të shpjegohet me homoniminë e këtyre dy fjalëve. Edhe sikur nga ana etimologjike të pranohet e vërtetuar, që këtu kemi të bëjmë me të njëjtën fjalë, ato duhen marrë si homonime semantike, të lindura nga zberthimi i polisemisë. Një përjashtim i ngjashëm ka ngjarë edhe me kuptimin e vjetër të fjalës *gjellë* për jetë, sot në shqipen jeton vetëm kuptimi për gatimin që hamë, ndërsa i vjetri ra, me që të dy i perkasin të njëjtës sferë të fjalëve të përdorimit të përditshëm.

Siç del nga këta shembuj, ndeshja e homonimeve ngjet dhe sjell në rënien e fjalëve atëhere, kur për shkak të homonimisë lindin keqkuptime, prishet qartësia dhe njëkuptimësia e shprehjeve e mendimeve, vështirësohet përdorimi i një fjale ose tjetre. Veçanërisht e padëshirueshme bëhet homonimia, kur njera nga fjalët ka kuptim të keq, të papëlqyeshëm ose qesharak.

Fjala që bie, kur shenon një nocion të domosdoshëm, zëvendësohet me një sinonim të marrë nga burime të ndryshme.

2. Ndryshimet e pjesëshme të fjalëve, kundërveprimi i gjuhës në drejtime të tjera ngjet po për ato arësye, si edhe rënia e tyre. Ndryshimet mund të prekin anën fonetike të fjalës, atë morfologjike, fjalëformimin dhe përdorimin leksikor.<sup>3</sup>

a — Nga gjuhët sllave në shqipen ka hyrë një çift homonimesh *kosë<sub>1</sub>* për një vegël bujqësore dhe *kosë<sub>2</sub>* për gërshet. Në zhvillimin e tyre fonetik këto fjalë duhet të ecnin njësoj, me që janë në kushte të njëjta. Megjithatë për *kosë<sub>2</sub>* kemi trajtën e përhapur *koce-t*. Ka të ngjarë që ky ndryshim

2) Shih E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, VIII, «Bul.Un.Sht. të Tiranës, S.Shkenc.Shoq.» 1962, Nr. 3, f. 62.

3) Për rolin e homonimisë në ndryshimet fonetike dhe morfologjike të disa fjalëve të shqipes ka shkruar P. Skok në *Du rôle de l'homonymie dans les créations phonétiques et morphologiques V, VI, VII*, në «Casopis Moderne Filologije» 16,17, vitet 1929, 1930, 1931.

ta ketë burimin në nevojën për të shmangur homoniminë dhe ka ndjekur këtë rrugë ndoshta nën ndikimin e *gocë*. Po kështu, në se e marrim si të vërtetuar tashmë që fjala *kapucar* për atë që zbulon e kallzon një vjedhje a faj tjetër kundrejt një shpërblimi, është një me *këpucar*<sup>4</sup>, atëhere ngulitjen e formës *kapucar* mbetet ta shpjegojmë me prirjen për të shmangur homoniminë me anë të një dryshimi të pjesëshëm fonetik.

b) Nga ana morfologjike, gjinia dhe numri i emrave shërbejnë më shpesh si mjete për të shmangur homoniminë. Rrjedhimisht së pari këtu kemi të bëjmë me format homonimike të të njëjtës fjalë, me raste të homonimisë gramatikore. Mendohet<sup>5</sup> se emri *dru* ka qënë asnjans në trajtën *drutë*. Mirëpo kjo përputhej me formën e shumësit *drutë* dhe prandaj forma e asnjansit u zhduk. Po kështu është shpjeguar sajimi i formave të reja e mashkullore të njëjësit për fjalët *sytë*, *veshëtë*, *gjitë*, për të evituar homoniminë morfologjike.<sup>6</sup>

Në shembujt e mëposhtëm, kufiri i homonimisë dhe i polisemisë është mjaft i diskutueshëm, megjithatë kjo nuk e ndryshon thelbin e çështjes, lidhur me gjininë e numrin si mjet diferencimi. Fjalët *fre-ri* (*fre-ni*) dhe *frena-t* janë po nga ai burim dhe dukej të kishin edhe kuptimet e njera tjetrës. Megjithatë ato dallohen mirë lidhur me sendet që shenojnë, ndërsa toskërishtja ka marrë dhe përdor trajtën e gegërishtes për frenat e makinave ose në kuptimin e figurshëm *frenat e shtetit*, ndonse e kishte trajtën e vet.

Nga vargu i fjalëve që kanë filluar të përdoren në gjini të ndryshme, për të diferencuar kuptimet si fjalë të veçanta, po përmëdim: *këshill-i* për një organ të pushtetit dhe organe të tjera kolegjiale në gjuhën e shkruar dallohet nga *këshillë-a* lidhur me foljen *këshilloj*; po ashtu *rrjetë*, kur shenon sistemin e dyqaneve të tregëtisë sot përdoret mashkullore: *rrjeti i tregëtisë*; fjala *rregull-i* dallohet mirë në përdorim nga *rregullë-a*; një proces i tillë diferencimi po vihet re edhe për fjalë të tjera, si: *trup-i* dhe *trupë-a*, *problem-i* dhe *problemë-a*, etj.

c) Në fushën e fjalëformimit zgjerimi i mëtejshëm i fjalës e mbron atë nga ndeshja homonimike<sup>7</sup>, ndërsa homonimia mund të sjellë në modele të ndryshme të fjalëformimit.

Nga homonimet *gaz* për gëzim dhe *gaz trup* i gaztë kemi kompozitat *gazprurës* që sjell gëzim dhe *gazsjellës* për transportimin e gazit. Megjithëse formalisht secila nga kompozitat mund të shërbente për të dy kuptimet, për shkak të homonimisë është bërë një diferencim i qartë i tyre dhe përdoren vetëm në kuptimet që u treguan.

4) Shih. E Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, XI, «Bul.Un.Sht. të Tiranës, S.Shkenc.Shoq.» 1963, Nr. 4, f. 85.

5) Shih E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, IV, «Bul.Un.Sht. të Tiranës, Seria Shkenc. Shoq. 1961, Nr. 3, f. 62.

6) Shih E. Çabej, *Gjon Buzuku*, në «Bul. për Shkenc.shoq.» 1955, Nr. 3, f. 61.

7) Megjithatë, me sa duket nuk është vetëm homonimia ose paronimia, që ka shpënë në zgjerimin e mëtejshëm në *-të*, ose *-t* tek mbiemrat si *i shumë*, *i pakë*, *i largë*, *i afër*, siç është theksuar nga prof. E. Çabej: «ky zgjerim... ka dalë më shumë nga gjuha e shkruar, për të shquar mirë mbiemrin nga ndajfolja përkatëse» (shih *Gjon Buzuku* «Bul. për Shkenc. Shoq.» 1955, Nr. 4, f. 120, edhe *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe*, «Bul. Un.Shtet. të Tiranës, S. Shkenc. Shoq.» 1963, Nr. 3, f. 89 dhe gjetkë). Ndoshta arsye tjetër plotësuese këtu do jetë dhe prirja e theksuar e gjuhës së shkruar për t'ju përshtatur sa më shumë një model të vetëm produktiv. Në këtë rast modelin produktiv në *-të* ose *-t*, si duket e ka përcaktuar denduria e përdorimit dhe numri i madh i mbiemrave të lëndës (*i ngurtë*, *i artë*, *i lëngët*, *i drunjtë*, etj.), i mbiemrave nga pjesoret (*i ftohtë*, *i ngrohtë*, *i hapët*; etj.), si dhe i disa të tjerëve mjaft të përdorur (si: *i fortë*, *i lartë*, *i vërtetë*, etj.).

Në çiftin *pjekje*<sub>1</sub> të *pjekurit* dhe *pjekje*<sub>2</sub> takim, e para po përdoret gjithnjë e më tepër në gjuhën e përbashkët, ndërsa e dyta po zëvendësohet me sinonimin *takim*, megjithatë në fjalën e përbërë *pikëpjekje* nuk ngrihet më çështja e homonimisë e prandaj mund të përdoret më tej pa lindur vështirësi. Edhe tek *veshmbathje* pjesa e dytë ruan një kuptim që nuk e ka si fjalë më vehte, po ashtu si pjesa e dytë tek fjala *gjëkafshë*. Tek të dyja gjymtyra e dytë do të ngatërrohej me kuptimet që kanë këto fjalë si fjalë më vehte, ndërsa kompozimi e ka shmangur këtë ngatërrim.

d) Dallimi i homonimeve *bebe*<sub>1</sub> qendër e syrit dhe *bebe*<sub>2</sub> për foshnjë arrihet në një rrugë tjetër. *Bebe*<sub>1</sub> përdoret më shpesh në togfjalëshin *bebe e syrit*. Po kështu *gocë*<sub>1</sub> në kuptimin guaskë pothuajse gjithnjë përdoret në togun *gocë deti*, për t'u dalluar nga homonimi *gocë*<sub>2</sub> për vajzë, që përdoret po në atë dialekt. Na duket se togfjalëshi shërben në këto raste jo për të krijuar një njësi të re leksikore, si ngjet rregullisht me togfjalëshat e tjerë të qëndrueshëm (të tipit *lakuriqi i natës*) por vetëm për të zbutur homoniminë.

II. Kontaminimi homonimik, shkrirja e dy fjalëve të ndryshme në një dhe ndikimi reciprok i kuptimeve ngjet kur kuptimet kanë ndonjë afërsi qoftë edhe të jashtme e mund të lidhen në një farë mënyre. Me sa duket, kjo ngjet rrallë me fjalë, të cilat lidhen drejtpërdrejt me sendet konkrete e të përdorimit të përditshëm, që kanë kuptim të përcaktuar qartë, ndërsa është më tepër e mundëshme me fjalë të përgjithëshme e abstrakte, veçanërisht me foljet, ose gjatë huazimeve të ndryshme, kur bëhen përpjekje për ta përvehtësuar më lehtë fjalën e huaj, duke e lidhur me ato të gjuhës.

Etimologjia njih disa raste, kur fjalë të ndryshme, për shkak të homonimisë së rrënjëve të tyre me tingëllim të njëjtë ose të ngjajshëm kanë ndikuar njera mbi tjetrën e janë kryqëzuar. Kështu mendohet se tek fjala *amull*, bashkë me fjalët e tjera të lidhura me të, kemi kryqëzim të disa kuptimeve e formave, mundet dhe të disa fjalëve të ndryshme; në kuptimin e fjalës *dëfrej* ka ndikuar edhe *fryj*; për fjalën *gjyq* mendohet se janë marrë nga latinishtja *iudicium* dhe *iudicem* të cilat më vonë u përzjenë<sup>8</sup>; *mirat* ka hyrë lehtë në shqipen nga greq. *μουῦρα*, sepse u lidh më *mirë*.<sup>9</sup> Folja *ngjesh* për lidh mezin me brez, ve armët në brez, nga folësit e sotmë të rëndomtë nuk dallohet si fjalë më vehte nga *ngjesh* për mburuj, shtyp, ja vesh, sepse lidhen në bazë të kuptimit rras, fus, shtërngoj. Po kështu vetëm specialistët mund të dallojnë sot *endet*, si pësore nga *end* dhe *endet* për bredh, vij poshtë e përpjetë.

Homonimia dhe tingëllimet e ngjashme janë shkak e burimi kryesor i lindjes së etimologjive popullore.

Veçanërisht pjesëzat, parafjalët (si edhe parashtesat e prapashtesat) e sotme janë në mjaft raste rezultat i kontaminimit të disa fjalëve të ndryshme, me që ato nuk kanë kuptime të plota e të pavarura leksikore, me strukturë të qartë, gjë që e lehtëson ngatërrimin e tyre, mjafton të përfundojnë me tingëllim të njëjtë. Po kështu në fushën e homonimisë gramatikore mjaft forma të ndryshme, që janë përputhur nga ana tingë-

8) Për të tria fjalët shih E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, «Bul. Un. Sht. të Tiranës, S. Shk. Shoq.», përkatësisht 1960, Nr. 4, f. 18; 1961, Nr. 1, f. 52; 1962, Nr. 3, f. 71.

9) Shih E. Çabej, *Disa eufemizma të shqipes*, «Bul. Inst. të Shkencave», 1949, Nr. 1, f. 79.

llore, janë shkrirë me njera tjetrën, njera i ka marrë funksionet e tjetrës dhe është reduktuar numri i tyre, si ka ngjarë p.sh. me rasat.

Nga rastet kur fjala, për lehtësi përdorimi, lidhet me një tjetër edhe nga kuptimi për shkak të homonimisë, mund të përmëndim shprehjen *humbas pusullën*, që shqiptohet sikur të kishim të bënim vërtet me një *pusullë*, ndërsa fjala e vërtetë do të jetë *busullë* (khs. greq. *χάνω τόν μπούσολά μου*.)

Rastet që u sollën më sipër të ndikimit të homonimisë, natyrisht përfshijnë vetëm pak nga ajo, që mund të vërehet në gjuhën shqipe. Vetëm përfundimi i një atlasit dialektor, studimi i gjeografisë së fjalës do të lejojnë që të plotësohen njohuritë tona mbi ndikimin e vërtetë të homonimisë në gjuhën shqipe. Sido që të jetë, mendojmë se numri i këtyre çfaqjeve nuk do të dalë shumë i madh. Nëqoftë se do t'i shtojmë kësaj edhe faktin, që në gjuhën shqipe kemi numëruar mbi 300 çifte e grupe homonimesh që përfshijnë afër 1000 fjalë, pa përmëndur ato që gjenden vetëm brenda përbrenda njerit dialekt ose të folmje, atëhere lind pyetja: si bëhet e mundur që gjuha pajtohet me një numër të tillë jo të vogël homonimesh dhe vetëm në raste të rralla reagon ndaj tyre.

Para së gjithash, këtu duhet theksuar se qëndrimi i gjuhës letrare të përpunuar dhe i gjuhës së folur e dialekteve nuk është i njëjtë. Nëse në gjuhën letrare fjalët *hyj*, *mbyll*, *sy*, *tym*, etj. të shqiptuara me *-i*, ose asimilimet e njohura të grupeve të bashkëtingëlloreve *mb*, *nd*, etj. do të sillnin një homonimi të shpeshtë të padëshirueshme, në dialekt kjo as që vihet re. Së dyti, në fusha të ndryshme të përdorimit të gjuhës vihet re një qëndrim i ndryshëm ndaj homonimisë. Terminologjia përsëmbëll, në mënyrë të veçantë nuk i pranon fjalët në disa kuptime, kur këta lidhen me sende të ndryshme në realitet, terminologjia priret ndaj njëkuptimisë sa më të madhe, prandaj ajo që në gjuhën e përbashkët është polisemi, prej saj ndjehet si një homonimi e padëshirueshme, që duhet shmangur. Kështu në shenimin e Fjalorit të terminologjisë shkencore 10, Terminologjia e kimisë (Tiranë, 1963, f. 5) shkruhet «... mbaresa *-ium* është hequr tek emrat e atyre elementeve, që e kanë rrënjën shumërokëshe: *aluminium* është bërë *alumin-i*, *deuterium* *deuter-i*, *dysprosium* *dispros-i*, *europium* *europ-i*, etj., është ruajtur kjo mbaresë vetëm tek emrat *berilium-i*, *zirkonium-i*, për t'i dalluar nga *beril-i* dhe *zirkon-i*, që janë minerale, tek *einshteinium-i*, *gjermanium-i* që, pa mbaresën *-ium* janë emra të përdorur zakonisht si emra njerëzish». Si shihet, këto përjashtime janë nevojitur për të shmangur homoniminë. Së treti, ajo që ka më tepër rëndësi është se homonimia lind vështirësi në gjuhë vetëm në rrethana të caktuara.<sup>10</sup> Kur homonimet i përkasin të njëjtës fushë semantike ose sferave të afërta, e si rrjedhim lind mundësia e konteksteve me dy kuptime, atëhere homonimia ndjehet nga folësit. Nevojitet kështu që fjalët homonime të përdoren me të vërtetë brenda të njëjtës shtresë shoqërore, nga i njëjti grup folësish, ose në të njëjtin stil. Në rastet e tjera homonimia është vetëm diçka e mundëshme, potenciale, mbetet vetëm një homonimi jo gjithënjë reale ose e realizueshme, si e tillë ajo nuk ka përse të ngjallë vështirësi. Mendojmë se numri më i madh i homonimeve në shqipen janë pikërisht homonime të tilla të mundëshme, që dalin më shpesh kështu në fjalorë.

Në pjesën tjetër të homonimeve që i përkasin mbarë gjuhës, nuk ke-

10) Kjo është trajtuar hollësisht nga E. Öhmann në «Über die Wirkung der Homonymie im Deutschen», *Wirkendes Wort*, Jg. 9, Hf. 1, 1959.

mi rënie ose ndryshime të tyre për arsye të tjera. Së pari, një pjesë e mirë janë homonime leksiko-gramatikore, u përkasin pjesëve të ndryshme të ligjëratës, si të tilla kanë një përdorim kaq të ndryshëm në gjuhë, sa që tingëllimi i tyre i njëjtë mbetet diçka pa rëndësi. Emri *dhe-u* me vetën e dytë të foljes (ti) *dhe* nuk kanë rrezik të ngatërrohen, me që lidhen me paradigma krejt të ndryshme, kanë përdorim sintaksor e lidhje në fjali krejt të largëta.

Një pjesë tjetër e fjalëve janë homonime të pjesëshme, p.sh. foljet *pres<sub>1</sub>*, — *pres<sub>2</sub>*, e prandaj homonimia e tyre ngushtohet mjaft.

Në çiftet kur asnjë nga këta faktorë nuk vepron, vetë kuptimi i fjalëve bën që ato të përdoren në kontekste të tilla, që janë të mjaftueshme për të shmangur keqkuptimet. Konteksti vetë shërben për të shmangur ngatërrimet homonimike, ashtu si shërben për të dalluar kuptimet e ndryshme c të shumta të fjalëve polisemike.<sup>11</sup> Kështu p.sh. *verë* si pije nuk ka pse të ngatërrohet me *verë* si stinë kur themi: pi *verë*, mbush një gotë me *verë*. *verë* e kuqe, e ëmbël dhe anasjelltas, kur themi: *verës* pushojmë, në *verë* bën vapë, *verën* që vjen, etj.<sup>12</sup>

Së fundi, situata e të folurit ndihmon në rastet kur konteksti i afërm, që rrethon fjalën, nuk mjafton për përcaktimin e kuptimit të saj. Për shëmbëll, një frazë e tillë: *atje kemi patur verën e vitit të kaluar* në përgjithësi mund të kuptohet për verën si pije; më rrallë këtu mund të jetë fjala për diçka që pohohet se e kemi patur në një vend një vit më parë në verë. Kjo diçka është përmëndur më parë nga folësi dhe si e tillë ndjehet edhe në këtë fjali si një kundrinë e pashprehur. Situata e të folurit përcakton intonacionin e gjithë frazës, pauzat e nevojshme, theksi logjik e lehtëson zgjedhjen në favor të njerit kuptim. Frazat e tipit: *ai do të bëhet artist* dhe *ai dó të bëhet artist*, që ndeshen në të folur, janë të qarta pikërisht nga theksi logjik. Ndërsa kur shkruajmë mungesa e theksit logjik të shprehur grafisht mund të shpjerë në zgjerimin e foljes në *don*, për qëllime dallimi gjë që vihet re edhe në të folur për disa folje të tjera njërrokëshe kur nuk shquhen vetat.

Rrallë herë nuk ndihmon asgjë dhe linden keqkuptime, mosmarrëveshje të çastit, por që nuk përsëriten në mënyrë konstante dhe prandaj nuk e detyrojnë gjuhën të bëjë ndryshimet përkatëse. Rezultat i tyre janë lodrat e ndryshme të fjalëve (të tipit *qe si qe, u bë si ka*), të cilat krijojnë më tepër artificialisht në letërsi për kalambure dhe efekte stilistike e të rimës.

Kur asnjë nga faktorët e përmëndur më sipër nuk ndihmon, i mbetet homonimisë të ushtrisë ndikimin e saj. Si përfundim, mund të thuhet se çfaqjet e ndryshme të ndikimit të homonimisë nuk mund të përbëjnë një faktor të përhershëm, që vepron sipas disa rregullave të caktuara, e si e këtillë ajo të zinte në sistemin e gjuhës një vend si të gjithë fenomenet, ligjet e rregullat e tjera.

Që këtej mund të nxirret veçoria specifike e homonimisë në gjuhën shqipe. Ajo nuk është një rregull, një ligj, një marrëdhënie e lidhje e nevojshme në sistemin e gjuhës, ajo është vetëm një rezultat, një pasojë e veprimit të rregullave e ligjeve të tjera të gjuhës, që vetëm rrallë herë bëhet *shkak* ndryshimesh.

11) Lidhur me këtë N.N. Amosov shkruan: «Në këtë mënyrë, nga pikëpamja kontekstologjike, nuk ka ndonjë dallim ndërmjet polisemisë dhe homonimisë» në *Основы английской фразеологии*, А. 1965, f. 40.

12) Megjithatë, ndoshta këtu ka pjesën e vet edhe homonimia në përdorimin më të dëndur të fjalës *behar* në jugë, se sa në veri.